

KUADRI LIGJOR DHE PREVALENCA E DUHANPIRJES NË KOSOVË



Jon Hoti

Doktor i Mjekësisë

Abstrakti

Hyrje: Duhanpirja është ndër faktorët kryesor të rrezikut për sëmundje jo ngjyeshme dhe vdekje të parakohshme. Kosova ka ndërmarrë hapa ligjorë të rëndësishëm që nga viti 2013 për të ndaluar duhanin në mjediset e mbyllura publike dhe për të reduktuar përdorimin e tij në popullatë.

Qëllimi: Ky rishikim synon të shqyrtojë ndikimin e legjislacionit për kontrollin e duhanit në prevalencën e duhanpirjes në Kosovë, duke u mbështetur në të dhëna përfaqësuese dhe indikatorë që dalin nga pakoja e masave dhe kriteret për reduktimin e kërkesës, e përfshirë në Konventën Kornizë për Kontrollin e Duhanit-FCTC të OBSH-së, e njohur si MPOWER [2].

Metodologjia: Është kryer një analizë përmblendhëse e dokumenteve ligjore dhe udhëzimeve administrative të miratuara që nga viti 2013, si dhe e të dhënave sasiore nga studimet GYTS dhe STEPS, të kryera me nxënësit dhe të rriturit në Kosovë. Gjithashtu, është shqyrtuar edhe ecuria e ngritjes së taksës në duhan përgjatë periudhës 2013-2024.

Rezultatet: Ligji për Kontrollin e Duhanit [1] dhe masat shoqëruese kanë kontribuar në uljen e prevalencës së duhanpirjes në mesin e të rinjve dhe të rriturve. Megjithatë, shkeljet e ligjit, mos-zbatimi i plotë i tij, ndërhyrjet e industrisë së duhanit në politikat e kontrollit të duhanit, produktet alternative të nikotinës dhe cigaret elektronike, paraqesin sfida të vazhdueshme.

Diskutim: Megjithëse Kosova ka avancuar në aspektin normativ, zbatimi efektiv mbetet i kufizuar. Nevojitet forcim i mbikëqyrjes, ndërgjegjësim më i madh publik dhe rregullim ligjor për cigaret elektronike dhe produktet e reja të duhanit.

Përfundim: Legjislacioni i Kosovës për duhanin është në përputhje me FCTC dhe ofron bazë të mirë për mbrojtjen e shëndetit publik. Vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet forcimit të zbatimit dhe kontrollit efektiv të formave të reja të

produkteve me nikotinë.

Fjalë kyçe: Duhanpirja, Ligji për Kontrollin e Duhanit, MPOWER, prevalenca, Kosova

Hyrje

Epidemia e duhanit është një nga kërcënimet më të mëdha për shëndetin publik me të cilat është përballur ndonjëherë bota. Duhani vret mbi 8 milionë njerëz në vit në të gjithë botën. Më shumë se 7 milionë nga këto vdekje janë rezultat i përdorimit të drejtpërdrejtë të duhanit, ndërsa rreth 1.3 milionë vdekje, janë rezultat i ekspozimit të jo-duhanpirësve ndaj tymit të dorës së dytë [12]. Duhanpirja është një nga faktorët kryesor të rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare, kanceret dhe sëmundjet e frymëmarrjes. Në Kosovë, nevoja për ndërhyrje ligjore ishte evidente për shkak të prevalencës së lartë të përdorimit të duhanit dhe mungesës së mbrojtjes në hapësirat publike. Në vitin 2013, Kosova miratoi Ligjin për Kontrollin e Duhanit [1], i cili është në përputhje të plotë me Konventën Kornizë për Kontrollin e Duhanit të OBSH-së (FCTC) [2].


Qëllimi

Ky artikull synon të rishikojë kuadrin legjislativ për kontrollin e duhanit në Kosovë dhe të analizojë ndikimin e tij në prevalencën e përdorimit të duhanit në popullatën e përgjithshme, me fokus të veçantë te të rinjtë dhe të rriturit, duke përdorur të dhëna nga studimet përkatëse dhe indikatorët që dalin nga pakoja e masave MPOWER.

Metodologjia

Gjatë realizimit të këtij rishikimi u analizuan Ligji për Kontrollin e Duhanit Nr. 04/L-156, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2013 [1] dhe tri udhëzime administrative që burojnë nga ky ligj e që janë: Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 për mjediset pa tym duhani dhe vendosjen e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura [6]; Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet në hapësirat e lejuara për pirjen e duhanit [5] (në institucionet ku

Përdorimi i duhanit te të rinjtë 2005 dhe 2016



Grafiku 1: Përdorimi i duhanit në mesin e nxënësve të moshës 13-15 vjeç në Kosovë më 2005 dhe 2016. Burimi: IKSHPK, GYTS 1 dhe GYTS 2

KUADRI LIGJOR DHE PREVALENCA E DUHANPIRJES NË KOSOVË



Faik Hoti

Specialist i Shëndetësisë
Publike

trajtohen personat me çrregullime mendore, nw institucionet korrektuese dhe në hotele) dhe Udhëzimi Administrativ (Nr. 05/2023 për Vërejtjet e Kombinuara, respektivisht Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e UA Nr. 05/2023 për Vërejtjet e Kombinuara [3, 4].

Gjithashtu, u analizuan edhe të dhënat nga studimet si: "Hulumtimin gjithëpërfshirës i duhanpirjes tek të rinjtë në Kosovë", i njohur si GYTS 1, 2005 [7] dhe GYTS 2, 2016 [8] dhe "Prevalenca e pirjes së duhanit në mesin e popullsisë së rritur të Kosovës: Rezultatet e anketës STEPS 2011 [9] dhe STEPS 2019 [10].

Rishikimi mori në konsideratë edhe indikatorët rreth zbatimit të masave MPOWER [11] si dhe ndryshimet në nivelin e akcizave për produktet e duhanit gjatë periudhës 2013-2024 ([13].

Rezultatet

Sa i përket ndikimit tek të rinjtë, GYTS 2 (2016) që u realizua në 66 shkolla në gjithë vendin dhe ku në hulumtim kanë marrë pjesë 5031 nxënës nga klasët e përzgjedhura 7, 8 dhe 9, tregoi se përdorimi i duhanit te të rinjtë nga 6.7% sa ishte më 2005 kur u realizua GYTS 1, shënoi rënie në 4.4% më 2016, derisa duhanpirja pasive nga 84% (2005), shënoi rënie në 43% (2016). Të dy këto ndryshime lidhen drejtpërdrejt me efektet e hyrjes në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit më 2013 dhe zbatimin relativisht efektiv të tij në vitet e para, para realizimit të GYTS 2 (2016).

Ndërkaq, sa i përket ndikimit tek të rriturit, STEPS – anketa e bazuar në popullatë, u krye me persona të moshës 18-69 vjeç nga prilli 2018 deri në qershor 2019, duke përdorur instrumentin STEPS të OBSH-së. U realizua në 2800 familje të përzgjedhura rastësisht, prej të cilave 2695 pranuan të merrnin pjesë në anketë (shkalla e përgjigjes 96.2%).

Sipas gjetjeve të studimit, 25.7% e popullsisë së moshës 18-69 vjeç ishin duhanpirës aktual (burra 35.3% kundrejt grave 15.9%) dhe 90.1% e tyre


pinin duhan çdo ditë (burra 91.5% duhanpirës aktualë çdo ditë kundrejt grave 87.1% çdo ditë). Duhanpirësit filluan të pinin duhan në një moshë mesatare prej 19.3 vjeç. Gratë filluan të pinin duhan dukshëm më vonë se burrat, në moshën 20.9 vjeç, krahasuar me 18.6 vjeç për burrat, dhe grupmosha më e re filloi të pinte duhan më herët.

Krahasuar me STEPS 2011, STEPS 2019 gjeti se nga 28% sa ka qenë përdorimi i duhanit më 2011 tek të rriturit, në vitin 2019 ra në 25.7%. Sipas hulumtimit, te meshkujt u shënuar rënie nga 35.2% në 32.3%, kurse te femrat nga 16.3% në 13.9%.

Sa i përket zbatimit të masave dhe kritereve për reduktimin e kërkesës -MPOWER [11], ku përfshihen gjashtë masa: M-Monitoring-Monitorimi i përdorimit të duhanit dhe politikat e parandalimit; P-Protecting-Mbrojtja nga përdorimi i duhanit; Offering-Ofrimi i ndihmës për lënien e duhanit; W-Warning-Paralajmërimet për rreziqet nga duhani; E-Enforcing-Fuqizimi i ndalimit të reklamave, promovimit dhe sponsorimit dhe R-Raising-Rritja e taksave të duhanit, në disa prej tyre ka pasur progres të konsideruar. Me miratimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit është bërë përparim në masën e mbrojtjes dhe monitorimit dhe, gjithashtu, së fundi edhe me implementimin e paralajmërimeve për rreziqet nga duhani përmes aplikimit të vërejtjeve të kombinuara në produktet e duhanit (2024).

Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, importet e rregullta kanë shënuar një rënie prej -3.84% nga 2023 në 2024, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ për Vërejtjet e kombinuara.

Ndërkohë që mbetet për adresim çështja e ofrimit të ndihmës për lënien e duhanit (quit smoking), kryesisht snë kuadër të shërbimeve parandaluese të Kujdesit Primar Shëndetësor, një përkeqësim të madh ka pasur te masa e "fuqizimit të ndalimit të reklamave, promovimit dhe sponsorimit", si pasojë e ndërhyrjeve të



Grafiku 2: Përqindja e të anketuarve që pinë duhan në baza ditore, sipas gjinisë dhe viteve: Burimi: IKSHPK-Prevalenca e pirjes së duhanit në mesin e popullsisë së rritur të Kosovës-Rezultatet e anketës STEPS 2011 dhe STEPS 2019.

drejtpërdrejta mashtruese të industrisë së duhanit për të sponsorizuar e reklamuar duhanin përmes mediave (TV, portale...), duke përfituar edhe nga indiferenca e institucioneve monitoruese dhe mbikëqyrëse ndaj shkeljeve të tilla.

Konsiderohet se ndalimi i plotë i reklamave, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit mund të ulë konsumin e duhanit me një mesatare prej rreth 7%, derisa dëshmitë tregojnë se në disa vende, me aplikimin e ndalimit të reklamimit të duhanit, ka pasur rënie të përdorimit deri në 16%. Vetëm rreth 40 vende (përfshirë edhe Kosovën), që përfaqësojnë 15% të popullsisë botërore, i kanë ndaluar plotësisht të gjitha format e reklamimit, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit.

Politikat e taksave

Rritja e taksave të duhanit konsiderohet si mënyra me kosto më efektive për të zvogëluar përdorimin e duhanit, sidomos në mesin e të rinjve dhe të varfërve.

Rritja 10% zvogëlon konsumin e duhanit me rreth 4% në vendet me të ardhura të larta dhe rreth 5% në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Në këtë aspekt, nga hyrja në fuqi e Ligjit për Kontrollin e Duhanit më 2013, në Kosovë ka pasur një ngritje progresive të taksës në duhan.

Në vitin 2013, taksa në duhan ishte 27euro për kg/ cigare; në janar 2014 u ngrit në 32 euro/kg; në mars 2015 në 35 euro/kg; në korrik 2015 në 38 euro/kg; në janar 2016

në 41euro për kg, ndërsa më 2018 arriti në 45 euro për kg (1,000 cigare). Në vitin 2023 taksa u ngrit në 55 euro për kilogramë. Më 2024, me qëllim të përafritimit me Direktivën e Tatimit të Bashkimit Evropian mbi Duhanin (Direktiva 2011/64/BE), sipas së cilës akciza totale për një paketë cigare duhet të jetë të paktën 60% e çmimit me pakicë dhe jo më pak se 90 euro për 1 kg (1,000 cigare), Kosova rriti normën e akcizës në 65 euro për kilogram neto, duke shënuar një ngritje tjetër progresive në taksën e duhanit, por ende larg normës që përcakton Direktiva e BE-së për Duhanin.

Diskutim

Ligji për Kontrollin e Duhanit në Kosovë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt mbrojtjes së shëndetit publik dhe është cilësuar si një nga ligjet më të avancuara në rajon në kohën e miratimit të tij. Të dhënat tregojnë për një ulje të prevalencës, si tek të rinjtë, ashtu edhe tek të rriturit, por qëndrueshmëria duhet të provohet përmes hulumtimeve të tjera, të reja.

Megjithatë, zbatimi praktik i ligjit mbetet sfidues për shkak të shkeljeve të vazhdueshme në ambientet publike; mbikëqyrjes jo adekuatë nga inspektoratet; mungesës së kulturës shëndetësore për të zbatuar në tërësi ligjin; ndërhyrjeve të përhershme dhe mashtruese të industrisë së duhanit, përfshirë reklamën e tërthorta dhe të drejtpërdrejta në media dhe platforma online; futjes së produkteve të reja të nikotinës; cigaret elektronike,

Vapes dhe Sisteme të tjera elektronike të shpërndarjes së Nikotinës (ENDS), të cilat publikut i prezantohen në mënyrë mashtruese si më pak të dëmshme, etj.

Aktualisht, prioritet mbetet rregullimi me ligj i këtyre produkteve të reja, të cilat janë shumë të pranishme në treg dhe tërheqëse për të rinjtë, për shkak të marketingut të fortë të industrisë së duhanit dhe kundërvënies së dobët nga ana e institucioneve ligj zbatuese këtyre politikave mashtruese të industrisë.

Përfundime dhe rekomandime

Ligji për Kontrollin e Duhanit ka kontribuar në uljen e prevalencës së duhanpirjes dhe mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullatës Megjithatë, për të ruajtur dhe rritur përfitimet shëndetësore nga ligji, rekomandohet: Fuqizimi i mbikëqyrjes dhe inspektimit, me burime të dedikuara; Fushata të vazhdueshme edukative me fokus te të rinjtë; Rregullimi i cigareve elektronike dhe produkteve alternative, me të njëjtin rigorozitet si për produktet tradicionale të duhanit; Transparencë më e madhe nga mediat, institucionet dhe organizatat që mund të ndikohen nga industria e duhanit; Monitorim i vazhdueshëm i ndikimit të masave MPOWER, me raportim publik të përparimit dhe rritje e vazhdueshme e taksave në produktet e duhanit me qëllim të arritjes së normës së shteteve të BE-së, sipas Direktivës 2011/64/BE për Tatimin mbi Duhanin.

Referencat:

1.Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 2013.

2.World Health Organization. WHO Framework Convention on Tobacco Control (FCTC). Geneva: WHO; 2003.

3.Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr. 05/2023 për Vërejtjet e Kombinuara; 2023.


4.Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e UA Nr. 05/2023 për Vërejtjet e Kombinuara; 2024.

5.Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet në hapësirat e lejuara për pirjen e duhanit; 2022.


6.Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 për mjediset pa tym duhani dhe vendosjen e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura; 2015.

7. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës. Hulumtimi gjithëpërfshirës i duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë (GYTS 1). Prishtinë: IKSHPK; 2005.

8. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës. Hulumtimi gjithëpërfshirës i duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë – GYTS Kosova 2016. Prishtinë: IKSHPK;



Grafiku 3: Moshë mesatare e fillimit të duhanpirjes, sipas gjinisë. Burimi: IKSHPK-Prevalenca e pirjes së duhanit në mesin e popullsisë së rritur të Kosovës- Rezultatet e anketës STEPS 2019.



Grafiku 4: Ngritja progresive e normës së akcizës së duhanit €/kg (2013-2024). Burimi: Dogana e Kosovës, 2023